



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

Nr. 5330 prot.,

Vlorë, më 19.04.2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ datë _____ 2024

PËR MIRATIMIN E PRIVATIZIMIT DHE TË VLERËS SË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE SHTETËRORE TË PAPRIVATIZUARA

Këshilli i Bashkisë, në bazë të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore », neni 8/2, neni 9 pika 1.1/b,c, neni 30/2, neni 54 pika e,n, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 «Për strehimin social » të ndryshuar neni 77/1,a të VKM Nr.179 datë 26.02.2020 “Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr.7652 datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore të paprivatizuara” dhe i ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”, pasi mori në shqyrtim e paraqitur nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike ;


VENDOSI

1. Të miratojë privatizimin e banesave shtetërore të paprivatizuara për shtetasit me të dhënat sipas tabelës së mëposhtme.
2. Të miratojë vlerën e apartamentit, që do të privatizojnë këta shtetas.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015, neni 55, pika 6

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr.banese	Nr.pasurie	Struktura e apartamentit	Sipërfaqja / m2	Viti i ndërtimit	Vlera e plotë e privatizimit (lekë)
1	Gjomistër	Zenel	Troqe	1140	24/49+1-19, ZK.8603	2+1 me aneks	62	1979	185319
2	Eqerem	Elmas	Elmazi	1035	27/15+1-4, ZK.8603	1+1 pa aneks	47,40	1973	87437

KRYETAR

Ermal Dredha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

RELACION

Mbi projekt-vendimin "Për miratimin e privatizimit dhe të vlerës së privatizimit të banesave shtetërore të paprivatizuara"

Në Bashkinë Vlorë kanë paraqitur kërkesën për privatizimin e banesës shtetërore të paprivatizuar shtetasit;

1. Ilir Gjomistër Troqe, sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore, është trashëgimtar i Gjomistër Troqe, me këto të dhëna të banesës:

-Pallati nr.1140, shkalla e parë, kati i pestë, apartamenti 19, (2+1) me aneks, lagja "28 Nëntori", Rruga "Misto Mele", Rajoni nr.3, Vlorë.

Sipas plan rievimit të hartuar nga topograf i licencuar kjo është pasuria me 24/49+1-19, ZK 8603.

2. Adrian Eqerem Elmazi, trashëgimtar i Eqerem Elmas Elmazi me të dhëna të banesës :

Pallati nr.1035, shkalla e parë, kati i parë, apartamenti nr.4, (1+1) pa aneks, me sipërfaqe 47,40 m2. Nr.pasurie 27/15+1-4, ZK.8603.

Bazuar në ligjin nr.22/2018 datë 03.05.2018 «Për strehimin social » neni 77/1,a, në VKM Nr.179 datë 26.02.2020 "Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr.7652 datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore të paprivatizuara" dhe i ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore", këta shtetas kanë paraqitur dokumentacionin si vijon :

1.Kontrata e qirasë me shtetin para vitit 1992, ose vërtetim lëshuar nga ish-ndërmarrja komunale banesa, që vërteton faktin e të qenit me qiramarrës, pa privatizuar banesën .

2. Çertifikatë familjare e 1.12.1992 dhe çertifikatë familjare aktuale.

3. Planimetri dhe plan rievimi të banesës të hartuar nga topograf i licencuar.

4. Dëshmitë e trashëgimisë ligjore të hartuara nga noteri për personat, të cilët kanë pasur emrin si qiramarrës në kontratën e qirasë me shtetin para vitit 1992 dhe kanë ndërruar jetë.

Duke qenë se në bazë të kontratës së qirasë me shtetin para vitit 1992 figuron apartamenti në emër të Gjomistër Troqe dhe ai ka ndërruar jetë, nga personi kërkues Ilir Troqe janë paraqitur dëshmia e trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Gjomistër Troqe, si edhe dëshmia e trashëgimisë ligjore për Farfuri Troqe, dëshmia e trashëgimisë ligjore për Ardian Troqe, që kanë ndërruar jetë. Pasi kontrata e privatizimit do të lidhet me rrethin e bashkëpronarëve sipas çertifikatës së gjendjes familjare 1.12.1992 dhe të trashëgimtarëve ligjorë të tyre për personat që kanë ndërruar jetë.

Vlera e plotë privatizimit përbëhet nga ;

a) Vlera e privatizimit të banesës dhe

b) Vlera e privatizimit të truallit

Banesa është ndërtim i vitit 1979, pra 45 vjet.

Tarifa e privatizimit për apartamentin me strukturë (2+1), kategoria e dytë, me 45 vite vjetërsi, është 13500 lekë. Me kryerjen e të gjitha veprimeve vlera e privatizimit për banesën është 185319 lekë.

2. Për apartamentin e trashëgimtarëve të Eqerem Elmazi, pallati është ndërtuar në vitin 1973, apartament (1+1) pa aneks, nuk ka tarifë privatizimi. Vlera e privatizimit të apartamentit përbëhet vetëm nga vlera e truallit në bashkëpronësi.

Vlera e truallit për apartamentin me sipërfaqe =47,40 m², koeficientin e bashkëpronësisë =0,27,

Çmimin e truallit =1080l/m² dhe indeksin e korrigjimit të çmimeve i=6,32597222, është

Vlera =87437 lekë.

Sa më lart kërkohet nga Këshilli i Bashkisë, të miratojë këtë projekt-vendimin për tu krijuar mundësinë qytetarëve të mësipërm të përfundojnë procedurat e privatizimit të apartamenteve të tyre, me qëllim pajisjen me çertifikatën e pronësisë.

KRYETAR
Ermal Dredha

